

V E N D I M

Nr. 808, datë 24.12.1998

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 396, DATË 26.9.1997, NR. 335, DATË 2.9.1997 DHE NR. 382, DATË 20.5.1996

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 2, të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 26.9.1997 “Për detyrat e grupit të mbikëqyrjes të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 5, shtohet ky paragraf, me këtë përmbajtje:

“Fondi i pagave dhe i shpenzimeve administrative, që kryhen për llogari të Grupit Mbikëqyrës, të parashikohen si zë i veçantë në buxhet brenda buxhetit të Kryeministrit.

Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“Përpunimi i dokumentacionit financiar të shoqërive huamarrëse dhe përgatitja e regjistrave për rishpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve, kryhet pranë Qendrës së Informatizimit Financiar.

Shpenzimet e përpunimit të deklaratave të kreditorëve përballohen me të ardhurat që sigurohen nga shitja e tyre kreditorëve.

Për llogaritjen e borxhit të shoqërive huamarrëse shpenzimet mbulohen nga buxheti i shtetit dhe caktohen si zë i veçantë në shpenzimet e Grupit Mbikëqyrës”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 2.9.1997 “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, në pikën 3 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Grupit Mbikëqyrës për kontrollin e shoqërive huamarrëse”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore, suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit””, në listën për grupin e dytë germa “A”, në pikën 9, të nenit 1 të këtij ligji, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje: “Kryetari i Grupit Mbikëqyrës për kontrollin e shoqërive huamarrëse”.

4. Anëtarët e Grupit Mbikëqyrës barazohen në trajtim me zëvendësministrat dhe gëzojnë të gjitha të drejtat e përfituara nga ana e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko